# DËSHMI ARKIVI

**A-438555**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Osmani për marrëdhënien me Trump: Ishte e sinqertë dhe i shërbeu interesit strategjik të Kosovës - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/osmani-per-marredhenien-me-trump-ishte-e-sinqerte-dhe-i-sherbeu-interesit-strategjik-te-kosoves/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 15:09:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 15:04:40 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e5587a844a0221a182c126e3ecca0b7b821842b5ce817748ef483a3945371e97` |
| TEKSTI | `009f6d20a8f076278d9b7e4c37e3a01c7a36f17d718624a3b6e03b763d80cf7f` |
| PAMJA | `00022719fc41d6859403317b82b825786648ac2d71545c1d4d9c2e0b27700a7a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `aa6bad64c9a55a868a6609417bb4304c50a2315e94efbcb5d180f59d3235c8ca` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0983af8cf4e72d1a6b153746aae6f13ef956ce66d20f7becf6209914f4319bfe` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/aa6bad64c9a55a868a6609417bb4304c50a2315e94efbcb5d180f59d3235c8ca`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

INSIDE ALBANIA | KOSOVË

# Osmani për marrëdhënien me Trump: Ishte e sinqertë dhe i shërbeu interesit strategjik të Kosovës

12 Shtator 2026 | 17:04

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ftuar në **"Inside Albania"** në **Euronews Albania**, ka folur për marrëdhënien e saj me Presidentin amerikan Donald Trump dhe administratën e tij, duke e cilësuar atë si një marrëdhënie të sinqertë, por njëkohësisht edhe në shërbim të interesave strategjike të Kosovës.

E pyetur nëse afrimiteti me Trump ishte një miqësi e vërtetë apo pjesë e një strategjie për të ruajtur Shtetet e Bashkuara si aleatin kryesor të Kosovës, Osmani tha se të dyja qëndrojnë.

"Shikoni, ishin të dyja, sepse njëra nuk e përjashton domosdoshmërisht tjetrën. Mund të kesh një marrëdhënie të vërtetë me liderët botërorë dhe në të njëjtën kohë, kjo t'u shërbejë interesave strategjike të vendit tënd. Pra po, ishte sigurisht një marrëdhënie shumë e sinqertë, do të thoja, jo vetëm me Presidentin Trump, por edhe me shumë prej anëtarëve të ekipit të tij të ngushtë", tha Osmani.

Ajo vlerësoi gjithashtu marrëdhënien me Sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio, duke theksuar qëndrimin e tij ndaj Kosovës dhe luftërave në ish-Jugosllavi.

"Sekretari Rubio ka mbajtur një qëndrim kaq të qartë moral dhe të drejtë ndaj Kosovës dhe ndaj luftërave të ish-Jugosllavisë që nga koha kur ishte senator. Ne kishim një marrëdhënie shumë të mirë me të shumë kohë përpara se të bëhej Sekretar i Shtetit dhe më pas përmes tij edhe me Presidentin Trump dhe shumë nga ekipi dhe këshilltarët e tij. Pra, ishte absolutisht i sinqertë, por në të njëjtën kohë, absolutisht edhe i shërbeu interesit strategjik të Kosovës", u shpreh ajo.

Sipas Osmanit, historia ka treguar se bashkëpunimi i ngushtë me Shtetet e Bashkuara ka qenë vendimtar për sukseset e Kosovës.

"Çdo herë që Kosova ka punuar shumë ngushtë me Shtetet e Bashkuara, kemi pasur sukses të qartë, qoftë ai çlirimi, pavarësia, fitorja e çështjes sonë përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sjellja e donatorëve për të rindërtuar Kosovën, njohjet, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare. Çdo sukses i Kosovës, ndërtimi i forcës sonë policore, ndërtimi i ushtrisë sonë, ndërtimi i sistemit tonë gjyqësor, çdo institucion në Kosovë, çdo sukses ndërkombëtar ka gjurmën e Shteteve të Bashkuara kudo", tha Osmani.

Ish-presidentja tha se gjatë mandatit të saj u ndërtua një marrëdhënie besimi me administratën Trump, e cila, sipas saj, krijoi një mundësi që Kosova nuk e kishte pasur që

LAJMI I FUNDIT

16:54 Osmani flet për marrëdhënien me Albin Kurtin: Kemi ende dallime, por kemi arritur të punojmë së bashku

16:53 Turistët e huaj dominojnë turizmin në Korçë, zgjatet qëndrimi

16:46 Vjosa Osmani zbulon planet pas Presidencës: A do të rikthehet në garën për kryeministre?

16:45 Takimi i Ramës me qytetarët në Vlorë, policia shoqëron aktivistin Baki Goxhaj

16:21 "Requiem for the Living", koncert në kujtim të viktimave të 11 Shtatorit

16:10 Takim me qytetarët për Reformën Territorialen, Rama mbërrin në Vlorë (VIDEO)

TESTIM

administratën Trump, e cila, sipas saj, krijoi një mundësi që Kosova nuk e kishte pasur që prej shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.

“Ndërtuam një marrëdhënie besimi, e cila na hapi një dritare mundësie që nuk e kishim pasur që nga viti 2008, kur shpallëm pavarësinë. Shumë njerëz menduan se ishte një marrëdhënie transaksionale, por anëtarësimi në Bordin e Paqes nuk ishte transaksional.”

Osmani theksoi se në komunikimet e saj me nivelet më të larta të administratës amerikane, Kosovës nuk iu kërkua të bënte lëshime ndaj Serbisë.

“Kur flisja me nivelet më të larta në Shtetet e Bashkuara ata nuk na kërkuan kurrë të bënim ndonjë lëshim ndaj Serbisë. Pra, ata e ndanë plotësisht marrëdhënien Kosovë-SHBA nga marrëdhënia Kosovë-Serbi. Ne nuk e kishim pasur këtë që nga shpallja e pavarësisë dhe kjo ishte pikërisht ajo që Kosovës i duhej.”

E pyetur nëse marrëdhënia me Trump kishte sjellë edhe pasoja negative politike për Kosovën, Osmani e mohoi këtë.

“Jo, për Kosovën jo deri tani”, tha ajo.

Duke iu referuar takimeve të saj me nivelet më të larta politike në SHBA, Osmani shtoi:

“Por në takimet e mia politike me nivelet më të larta në Shtetet e Bashkuara, m’u tha shumë qartë: le të ecim përpara në marrëdhënien tonë.”

Osmani flet për marrëdhënien me Albin Kurtin: Kemi ende dallime, por kemi arritur të punojmë së bashku

**Shiko në:**


## LAJME TË SUGJERUARA

INSIDE ALBANIA | RAJONI | VIDEO

**Osmani flet për marrëdhënien me Albin Kurtin: Kemi ende dallime, por kemi arritur të punojmë së bashku**

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ftuar në “Inside Albania” në Euronews Albania, ka folur për marrëdhënien e saj me kryeministrin Albin Kurti, duke pranuar...

16:54 | 12/09/2026

INSIDE ALBANIA | KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI

**Vjosa Osmani zbulon planet pas Presidencës: A do të rikthehet në garën për kryeministre?**

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ftuar në “Inside Albania” në Euronews Albania, ka folur për të ardhmen e saj politike, mundësinë për të marrë...

16:46 | 12/09/2026

INSIDE ALBANIA

**Nadia Calviño: Shqipëria drejt BE-së, investimet, hekurudhat dhe turizmi i qëndrueshëm**

Nadia Calviño: Shqipëria drejt BE-së, investimet, hekurudhat dhe turizmi i qëndrueshëm

17:08 | 17/05/2026

**Follow Euronews on all platforms:**

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.